



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

PROGRAM ORIENTUES PËR MATURËN SHTETËRORE
(PROVIM ME ZGJEDHJE)

LËNDA
EKONOMI E BËRTHAMË

KOORDINATOR: ASTRIT DAUTAJ
VITI SHKOLLOR 2023-2024

PËRMBAJTJA

1	UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT	3
1.1	UDHËZIM I VEÇANTË	5
2	TEMATIKAT	9
2.1	TEMATIKA 1: EKONOMIA E TREGUT	9
2.2	TEMA 2: Ekonomia kombëtare	13
2.3	TEMA 3: EKONOMIA GLOBALE	15
2.4	TEMA 4: EKONOMIA NË PRAKTIKË	16
3	PESHAT E TEMAVE	17

1 UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Programi orientues i Maturës Shtetërore për lëndën “Ekonomi-Bërthamë”, përfshin konceptet më të rëndësishme të ekonomisë, njohuritë dhe aftësitë themelore që i duhen nxënësit në këtë lëndë. Programi orientues i Maturës Shtetërore për provimin me zgjedhje të lëndës së ekonomisë-bërthamë përbën një dokument të vlefshëm për mësuesit e gjimnazit, nxënësit e interesuar dhe specialistët e përfshirë në procesin e hartimit dhe vlerësimit të testit të maturës shtetërore.

- Programi përmban dhe siguron informacionin e nevojshëm për mësuesit e ekonomisë së gjimnazit që do të përgatisin maurantët për provimin e ekonomisë-bërthamë si lëndë me zgjedhje në maturën shtetërore.
- Programi orienton nxënësit për njohuritë, konceptet dhe aftësitë kryesore që duhet të zotërojnë për të përballuar me sukses provimin e ekonomisë-bërthamë si lëndë me zgjedhje në maturën shtetërore.
- Programi përbën një dokument zyrtar që duhet zbatuar me korrektesë nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të ekonomisë-bërthamë si lëndë me zgjedhje për maturën shtetërore.

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes nga secili prej grupeve të interesit. Specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të ekonomisë-bërthamë si lëndë me zgjedhje për maturën shtetërore, duhet të mbajnë në vëmendje që nuk duhet të përfshijnë për vlerësim objektiva mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Banka e pyetjeve dhe teza e provimit duhet të përmbajnë vetëm ato koncepte, njohuri dhe aftësi të parashikuara në këtë program.

Mësuesit që do të përgatitin nxënësit për provimin e lëndës “Ekonomi-Bërthamë” t’i aftësojnë nxënësit jo vetëm për çështjet mësimore, njohuritë, konceptet dhe shprehitë e përcaktuara në këtë program, por të trajtojnë me ta edhe çështje që nuk trajtohen në tekstin e përzgjedhur, por që përmbajnë informacion të rëndësishëm dhe ndihmojnë nxënësit për të përvetësuar më mirë materialin e zgjedhur për provim.

Përgatitja e nxënësve për provimin e lëndës “Ekonomi-Bërthamë” të bëhet në mënyrë të vazhdueshme, që nxënësit të sigurojnë cilësinë e nxënies së çështjeve mësimore, të koncepteve kyçe dhe të aftësive intelektuale të përcaktuara në program.

Kujdes!

Në rastet kur njëri prej teksteve alternative nuk trajton një objektiv të caktuar të programit, atëherë **mësuesi i lëndës, që ka përzgjedhur këtë tekst, ka detyrën të plotësojë informacionin e domosdoshëm për realizimin e objektivit të parealizuar.**

Nuk është detyrë e nxënësit të sigurojë tekste të tjera për të realizuar objektivat e munguar!

1.1 UDHËZIM I VEÇANTË

Testi në provimin me zgjedhje të maturës shtetërore në lëndën “Ekonomi-Bërthamë”, do të ndërtohet në bazë të kërkesave dhe objektivave të programit të lëndës “Ekonomi-Bërthamë”.

Testi synon të vlerësojë atë çfarë di dhe është i aftë të bëjë nxënësi në fund të shkollës së mesme në lëndën e ekonomisë bërthamë, duke u bazuar në kërkesat e programit dhe në mundësitë që ofrojnë tekstet.

Kjo do të thotë se:

- a. **Maturanti testohet për të vlerësuar shkallën e përvetësimit prej tij të njohurive, të ideve dhe të koncepteve bazë të lëndës. Programi në vijim përmban pikërisht fushat, temat, çështjet dhe konceptet kryesore të përzgjedhura për t’u testuar në këtë provim.**
- b. **Maturanti testohet për aftësitë intelektuale të vëzhgueshme dhe të matshme, të synuara nga programi dhe të zhvilluara gjatë në lëndën e qytetarisë në shkollë, të tilla si:**
 1. Aftësia për të identifikuar dhe për të përshkruar (nivel i ulët i aftësive intelektuale).
 2. Aftësia për të shpjeguar dhe për të analizuar (nivel mesatar i aftësive intelektuale).
 3. Aftësia për të vlerësuar, për të marrë dhe për të mbrojtur qëndrime të caktuara (nivel i lartë i aftësive intelektuale).

1. Aftësia për të identifikuar dhe për të përshkruar

- **Të identifikosh** do të thotë të zbulosh kuptimin e gjërave të prekshme (p. sh., toka, vegla pune etj.) ose jo të prekshme (p.sh., kërkesa, oferta.). Të identifikosh diçka, do të thotë ta dallosh atë nga diçka tjetër, ta klasifikosh ose ta gruposh sipas ngjashmërisë etj. Për shembull, nxënësi të identifikojë faktorët e prodhimit për një të mirë ose shërbim.

- **Të përshkruash** do të thotë të dallosh, me shkrim ose me gojë, karakteristikat kryesore të një sendi ose dukurie. Këto mund të jenë sende të prekshme, konkrete, por mund të jenë edhe procese, institucione, qëllime etj. Për shembull, nxënësi të përshkruajë rëndësinë ekonomike të konsumatorit në ekonominë e tregut si dhe burimet e të ardhurave të individëve dhe format e tyre.

2. Aftësia për të shpjeguar dhe për të analizuar

- **Të shpjegosh** do të thotë të identifikosh, të përshkruash, të qartësosh ose të interpretosh diçka, p.sh.: shkaqet e ngjarjeve, kuptimin e ngjarjeve ose ideve të caktuara, arsyet për ndërmarrjen e veprimeve ose qëndrimeve të caktuara. Për shembull, nxënësi të shpjegojë konceptet pamjaftueshmëri, sistem ekonomik, kosto oportune dhe lidhjen shkakësore ndërmjet pamjaftueshmërisë dhe nevojës për të zgjedhur.
- **Të analizosh** do të thotë të ndash diçka në pjesët e saj përbërëse për të qartësuar kuptimin ose rëndësinë e saj, për shembull, për të kuptuar shkaqet e ngjarjeve, pjesët përbërëse dhe pasojat e ideve, e proceseve të caktuara shoqërore, politike ose ekonomike. Për shembull, nxënësi të analizojë ndërveprimin e ligjit të kërkesës dhe ofertës në çmimin ekuilibër.

3. Aftësia për të vlerësuar, për të marrë dhe për të mbrojtur qëndrime të caktuara

- **Të vlerësosh** do të thotë të përdorësh kritere ose standarde për të gjykuar, p.sh., për anët e forta ose të dobëta të qëndrimeve që lidhen me çështje të caktuara, synime, mjete etj. Për shembull, nxënësi të vlerësojë ndikimin e ndryshimeve të elasticitetit të kërkesës në sasinë e kërkuar.
- **Të marrësh një qëndrim të caktuar** do të thotë të përdorësh kritere ose standarde për të arritur në një qëndrim që individi e zgjedh nga një numër i caktuar qëndrimesh

ose në një qëndrim të ri. Për shembull, nxënësi të mbajë qëndrimin e tij për shkallën e ndërhyrjes së shtetit në ekonominë e tregut.

- **Të mbrosh një qëndrim të caktuar** do të thotë të përdorësh argumente dhe fakte që mbështetin atë qëndrim, ose të kundërshtosh një qëndrim të caktuar, duke marrë parasysh edhe argumentet që i kundërvihen qëndrimit tënd. Për shembull, nxënësi të mbrojë me argumente qëndrimin e tij për politikën e rritjes ose të uljes së taksave, duke mbajtur parasysh të gjitha argumentet e kundërta me të tija.

Model i shpërndarjes së pikëve që rrjedhin nga pyetje të niveleve të ndryshme në test

Nivelet e aftësive intelektuale		
Niveli i ulët	Niveli mesatar	Niveli lartë
Aftësia për të identifikuar dhe për të përshkruar...	Aftësia për të shpjeguar dhe për të analizuar...	Aftësia për të vlerësuar, për të marrë dhe për të mbrojtur një qëndrim të caktuar...
40%	40%	20%

Shembuj rezultatesh komplekse të nxëni, që mund të maten/vlerësohen:

1. me anë të testeve që varen nga një kontekst i caktuar, të cilët nxënësi, pasi i lexon ose i analizon në një material të caktuar informativ, i plotëson me një ose me më shumë detyra;
2. me anë të testeve me përgjigje të kufizuara;
3. me anë të testeve me përgjigje të zgjeruara.

1. Rezultate të nxëni, që mund të vlerësohen me anë të testeve që varen nga një kontekst i caktuar, janë, për shembull, aftësitë:

- për të dalluar lidhjet shkak-pasojë;
- për të dalluar zbatimin e parimeve;
- për të dalluar argumentet që kanë lidhje me çështjen;

- për të dalluar hipoteza të arsyeshme;
- për të dalluar përfundime të vlefshme etj.

2. Rezultate të nxëni, që mund të vlerësohen me anë të eseve me përgjigje të kufizuara, janë, për shembull, aftësitë:

- për të shpjeguar lidhjet shkak-pasojë;
- për të përshkruar zbatimin e parimeve;
- për të paraqitur argumente të vlefshme;
- për të formuluar hipoteza të arsyeshme;
- për të formuluar përfundime të vlefshme.

3. Rezultate të nxëni, që mund të vlerësohen me anë të eseve me përgjigje të zgjeruara, janë, për shembull, aftësitë:

- për të prodhuar, për të organizuar dhe për të shprehur ide;
- për të lidhur të nxënit në fusha të ndryshme të dijes;
- për të krijuar modele origjinale;
- për të vlerësuar ide të vlefshme.

2 TEMATIKAT

2.1 TEMATIKA 1: EKONOMIA E TREGUT

Nëntemat	Rezultatet e pritshme të të mësuarit
1.1 Çfarë studion ekonomia?	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">• shpjegon konceptet pamjaftueshmëri, sistem ekonomik, kosto oportune dhe lidhjen shkakësore ndërmjet pamjaftueshmërisë dhe nevojës për të zgjedhur, duke pranuar koston oportune;• jep shembuj personal lidhur me marrjen e vendimeve dhe koston oportune të saj;• identifikon faktorët e prodhimit për një të mirë ose shërbim;• interpreton një lakore të mundësive të prodhimit si dhe nëpërmjet saj ilustron koston oportune;• vlerëson mënyrën se si sisteme të ndryshme ekonomike e zgjidhin problemin ekonomik themelor;• përshkruan veçoritë e shtyllave të sistemit ekonomik të iniciativës së lirë;• përshkruan rolin e fitimit në sistemin e sipërmarrjes së lirë;• analizon se si ndërmarrja e iniciativave ekonomike nxit përdorimin e burimeve natyrore, të kapitalit fizik dhe njerëzor;• përshkruan fluksin e qarkullimit të aktivitetit ekonomik që lidh familjet, firmat e biznesit dhe qeveritë në ekonominë e tregut.
1.2. Kërkesa, oferta, dhe çmimi i tregut	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">• interpreton konceptet: treg, çmim, kërkesë, ofertë;• formulon ligjin e kërkesës dhe ofertës;

	<ul style="list-style-type: none"> • interpreton lakoren e kërkesës dhe ofertës; • shpjegon faktorët që shkaktojnë zhvendosjen e kërkesës dhe ofertës; • përcakton çmimin ekuilibër të një produkti të dhënë kur janë dhënë kërkesa dhe oferta për këtë produkt nëpërmjet grafikut; • bën dallimin midis një ndryshimi në sasinë e kërkuar ose të ofruar dhe një ndryshimi në kërkesë ose në ofertë; • vlerëson ndikimin e ndryshimeve të elasticitetit të kërkesës në sasinë e kërkuar dhe të ndryshimeve të elasticitetit të ofertës në sasinë e ofruar. • shpjegon se si ndikojnë në çmimin e tregut ndryshimet në kërkesë dhe ofertë; • analizon ndërveprimin e ligjit të kërkesës dhe ofertës në çmimin ekuilibër; • shpjegon se si çmimet e tregut bëjnë racionimin e mallrave dhe shërbimeve dhe motivojnë njerëzit për prodhimin e tyre.
<p>1.3. Konsumatori në ekonominë e tregut</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan rëndësinë ekonomike të konsumatorit në ekonominë e tregut si dhe burimet e të ardhurave të individëve dhe format e tyre; • shpjegon avantazhet dhe disavantazhet e blerjes me kredi; • shpjegon arsyet pse njerëzit kursejnë; • krahason metodat e ndryshme të kursimit; • analizon faktorët që ndikojnë në masën e kursimit; • përgatit një buxhet personal.
<p>1.4. Fillimi i një biznesi dhe financimi i tij</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shpjegon se si tregu i lirë nxit sipërmarrjen; • rendit format kryesore të organizimit të biznesit;

	<ul style="list-style-type: none"> • gjykon për avantazhet dhe disavantazhet e secilës prej tri formave kryesore të biznesit; • shpjegon organizimin e korporatës; • gjykon për disa nga përgjegjësitë, kërkesat dhe përfitimet që lidhen me sipërmarrjen; • dallon burimet e brendshme nga burimet e jashtme të financimit të biznesit; • shpjegon qëllimet dhe format e burimeve financiare të biznesit; • dallon ndryshimin ndërmjet aksionit dhe obligacionit; • analizon një bilanc dhe një pasqyrë të rezultateve financiare të firmës.
<p>1.5. Prodhimi, kostoja dhe të ardhurat e firmës</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • bën dallimin midis kostove fikse dhe atyre variabël; • llogarit koston e përgjithshme të prodhimit, koston mesatare dhe atë marxhinale; • interpreton grafikun e kostos fikse, variabël, të përgjithshme, mesatare, marxhinale; • llogarit të ardhurat e përgjithshme, të ardhurat marxhinale dhe të ardhurat mesatare; • llogarit produktin e përgjithshëm fizik, marxhinal, mesatar; • zbulon veprimin e ligjit të të ardhurave zbritëse në gjendjen e biznesit; • shpjegon funksionin e prodhimit për periudhën afatshkurtër; • tregon si llogaritet prodhueshmëria dhe si ndikon ajo në standardin e jetesës; • evidenton faktorët që ndikojnë në prodhueshmëri.
<p>1.6. Struktura e tregut</p>	<p>Nxënësi:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> • interpreton konceptet e konkurrencës dhe strukturës së tregut; • identifikon nivelin e konkurrencës së tregjeve në ekonomi; • shpjegon karakteristikat e secilës nga strukturat kryesore të tregjeve: konkurrencë e plotë, konkurrencë monopoliste, oligopol, monopol; • diskuton raportet dhe format e shkrirjes së bizneseve; • krahason strukturat e ndryshme të tregjeve; • analizon efektet ekonomike të strukturave të tregut mbi ekonominë dhe konsumatorin; • argumenton se zhvillimi i konkurrencës së lirë është në favor të të gjitha subjekteve në ekonominë e tregut.
<p>1.7 Tregjet e faktorëve të prodhimit</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • interpreton ofertën dhe kërkesën për faktorët e prodhimit; • interpreton ofertën për punë dhe kërkesën për punë; • shpjegon se si kërkesa dhe oferta për punë përcaktojnë çmimin e punës, çmimin e kapitalit, çmimin e tokës; • vlerëson shkallën në të cilën forcat e tregut dhe forcat jo të tregut ndikojnë në pagat.

2.2 TEMA 2: Ekonomia kombëtare

Nëntemat	Rezultatet e pritshme të të mësuarit
2.1. Qeveria dhe ekonomia	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">• shpjegon funksionin e qeverisë si arbitër dhe si subjekt në ekonominë e tregut;• shpjegon pse pjesëmarrja e qeverisë në ekonomi është rritur gjatë viteve;• përshkruan disa nga të ardhurat kryesore dhe shpenzimet në buxhetin për qeverinë shqiptare;• shpjegon arsyet që qeveria vendos taksa dhe pse taksimi nga qeveria është i nevojshëm;• vlerëson taksat, bazuar në parimet e vendosjes së tyre;• krahason tipat e ndryshëm të taksave, duke përfshirë taksat progresive, regresive dhe proporcionale;• interpreton konceptet e deficitit buxhetor, e borxhit publik dhe lidhjen midis tyre;• analizon përparësitë dhe mangësitë e deficitit buxhetor dhe borxhit publik;• përshkruan një ose disa propozime për të ulur deficitin buxhetor.
2.2. Paraja dhe institucionet financiare	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">• interpreton konceptin, karakteristikat, funksionet e parasë në një ekonomi monetare;• përshkruan procesin e lindjes dhe të zhvillimit të parasë duke evidentuar format e saj;• identifikon tipat e parasë që janë në qarkullim, në vendin tonë• shpjegon ofertën monetare, rolin e veçantë të bankave si

	<p>pranuese depozitash dhe dhënëse huash për ekonominë si dhe domosdoshmërinë e rezervës së detyrueshme bankare;</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan organizimin dhe funksionet e Bankës Qendrore të Shqipërisë.
<p>2.3 Treguesit kryesorë makroekonomik</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përcakton treguesit që përdoren për të matur gjendjen e ekonomisë; • shpjegon konceptin e GDP-së dhe se çfarë përfshihet në llogaritjen e GDP-së; • bën dallimin midis GDP-së reale dhe GDP-së nominale; • analizon kuptimin e GDP-së për frymë e shprehur në çmime aktuale dhe çmime konstante; • përshkruan metodat e matjes së GDP-së; • jep kuptimin për inflacionin, deflacionin; • dallon inflacionin e shkaktuar nga kostoja nga inflacioni i shkaktuar nga kërkesa; • shpjegon ndikimin ekonomik të inflacionit dhe format kryesore të inflacionit; • shpjegon fazat kryesore të ciklit të biznesit; • shpjegon konceptin e forcës punëtore; • dallon format kryesore të papunësisë.
<p>2.4. Stabiliteti ekonomik dhe politikat makroekonomike</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan mjetet e politikës fiskale; • shpjegon pse politikat fiskale janë vendime për të ndryshuar shpenzimet dhe/ose taksat nga qeveria; • interpreton efektet direkte dhe indirekte të politikës fiskale në papunësinë, prodhimin dhe normat e interesit; • përshkruan instrumentet e politikës monetare; • dallon instrumentet e politikës monetare nga ato të

	<p>politikës fiskale;</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan ndikimet dhe kufizimet e politikës fiskale si dhe ndikimet dhe kufizimet e politikës monetare; • identifikon rrugët në të cilat politika monetare ndikon në papunësinë, prodhimin, inflacionin dhe normat e interesit.
--	--

2.3 TEMA 3: EKONOMIA GLOBALE

Nëntemat	Rezultatet e pritshme të të mësuarit
3.1 Tregtia ndërkombëtare	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shpjegon konceptet e përparësisë absolute dhe krahasuese; • argumenton përfitimet që kanë vendet e industrializuara kur këmbëjnë midis tyre; • analizon përmbajtjen e tregtisë së lirë dhe përfitimet ekonomike të saj; • përshkruan disa pengesa në tregtinë ndërkombëtare; • jep në mënyrë të përmbledhur, argumentet që favorizojnë tregtinë e lirë; • përshkruan pse luhaten kurset e këmbimit valutor; • bën dallimin midis bilancit të pagesave dhe bilancit.

2.4 TEMA 4: EKONOMIA NË PRAKTIKË

Nëntemat	Rezultatet e pritshme të të mësuarit
4.1 Etika e biznesit	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">• përshkruan teoritë dhe konceptet që janë të zakonshme në studimin e etikës• përshkruan çështjet etike kryesore brenda vendit të punës dhe të botës përreth.
4.2 Aftësi për sukses	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">• identifikon aftësi të gatishmërisë në punë, të nevojshme për të kërkuar, për të gjetur dhe për të mbajtur një vend pune;• përshkruan lidhjet ndërmjet vlerësimit personal dhe dëshirave, vlerave, objektivave dhe aftësive të tij;
4.3 Financat personale	Nxënësi; <ul style="list-style-type: none">• përshkruan përbërësit themelorë të financave të tij personale si: fitimi, kursimi, investimi, kredia, menaxhimi i riskut etj.;• analizon rëndësinë e kursimit për financat personale dhe shpjegon rëndësinë e kursimeve të shëndetshme në të gjitha fazat e jetës;• identifikon risqe të mundshme për financat personale dhe disa nga rrugët për të parandaluar humbjet e mundshme.
4.4 Bëhu sipërmarrës!	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">• përshkruan karakteristikat dhe praktikat e sipërmarrjes së suksesshme;• vlerëson një ide sipërmarrëse, duke u bazuar tek

	<p>produkti, klienti dhe në kriteret e avantazhit konkurrues;</p> <ul style="list-style-type: none"> • vlerëson pasojat afatshkurtra dhe afatgjata të marrjes së vendimeve etike.
--	--

3 PESHAT E TEMAVE

TEMA	PESHA NE %
Tema 1	44%
1.1 Çfarë studion ekonomia?	6%
1.2. Kërkesa oferta dhe çmimi i tregut	15%
1.3. Konsumatori në ekonominë e tregut	5 %
1.4. Fillimi i një biznesi dhe financimi i tij	8%
1.5. Prodhimi, kostoja dhe të ardhurat e firmës	7%
1.6. Struktura e tregut	3%
Tema 2	38%
2.1. Qeveria dhe ekonomia	12%
2.2. Paraja dhe institucionet financiare	7%
2.3 Treguesit kryesorë makroekonomik	12%
2.4. Stabiliteti ekonomik dhe politikat makroekonomike	7%
Tema 3	6%
3.1 Tregtia ndërkombëtare	6%

Tema 4	12%
4.1 Etika e biznesit	3%
4.2 Aftësi për sukses	3%
4.3. Financat personale	3%
4.4 Bëhu sipërmarrës!	3%
Totali	100%